



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Zyra e Kryetarit

02 Nr. ____ /2025

Dt. 18/04/2025

PROCESVERBAL

Mbledhja e I-rë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Deçanit.

Mbledhja u mbajt me dt. 17.04.2025 ne ora 13:00

Rend dite :

1. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit;
2. Situata në Komune me ndriçim, parkingje, mbeturina, dhe pastrim të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave tjera;
3. Siguria në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme
4. Situata me qentë endacak
5. Të ndryshme

Të pranishëm ishin Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, drejtori i Arsimit, z. Besnik Hulaj, anëtarët e KKSB-së, përfaqësuesit e institucioneve lokale, Policisë së Kosovës, KFOR-it, përfaqësues të shkollave, komuniteteve dhe akterëve tjerë relevantë, monitorues nga OSBE-ja. Mbledhjen e hapi koordinatori i KKSB-së, znj. Gentiana Mazrekaj, e cila i përshëndeti të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e këtij mekanizmi për bashkëpunim dhe siguri në komunitet. Gjatë kësaj mbledhjeje u trajtuan këto pika të rendit të ditës:

1. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në komunë, informatë nga Policia e Kosovës
Rreshteri Adem Çeku nga Policia e Kosovës informoi se gjatë katër muajve të parë të vitit 2025 janë iniciuar gjithsej 80 raste. Si shqetësim i veçantë u theksua rritja e incidenteve në mesin e të rinjve. Gjithashtu, përfaqësues të KFOR-it shtruan pyetjen nëse stacioni policor në Deçan përdor dron – ku u sqarua se vetëm niveli qendror i Policisë së Kosovës ka në dispozicion këtë teknologji;

2. Situata me ndriçimin, parkingjet, pastrimin dhe hapësirat publike

Shefja e Shërbimeve Publike, znj. Gentiana Mazrekaj, njoftoi se problemet me ndriçimin publik tashmë janë tejkaluar dhe aktualisht të gjitha hapësirat publike mirëmbahen në mënyrë të rregullt. Ajo propozoi që policia të ketë më shumë kontrolle ndaj makinave që parkohen në trotuare.

3. Siguria në shkolla

Drejtori i Arsimit, z. Besnik Hulaj, raportoi se gjendja në shkolla është e qetë dhe nën kontroll. Takimet e rregullta me stafin arsimor ndihmojnë në parandalimin e rasteve problematike, dhe bashkëpunimi me Policinë e Kosovës është i vazhdueshëm.

4. **Çështja e qenve endacak** - sipas policisë është vërejtur një ulje e numrit të qenve endacak në vendbanimet e komunës dhe nuk janë raportuar incidente. Kryetari i komunës, z. Bashkim Ramosaj, njoftoi se komuna çdo vit bën marrëveshje me Institutin e Veterinës për trajtimin e qenve, dhe këtë vit është ndërmarrë edhe një aksion shtesë për zhvendosjen e tyre në një vend të caktuar nga një organizatë përkatëse.

5. Të ndryshme

Kryetari Ramosaj përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen, duke shprehur mirënjohje që komuna e Deçanit vazhdon të mbetet një vend i qetë dhe i sigurt. Ai theksoi se përkundër ndonjë rasti sporadik, niveli i përgjithshëm i sigurisë është shumë i mirë, si në shkolla ashtu edhe në hapësirat e tjera publike.

Në përfundim të mbledhjes u konstatua se situata në Komunën e Deçanit në përgjithësi është e qetë.



Procesmbajtëse:

Edona Kameraj

Edona Kameraj